

822 TË DHËNAT E BARASVLERSHME NË SISTEMET E TJERA

Fusha përmban informacione për të dhënat e barasvlershme në sistemet e tjera dhe mundëson ndërveprueshmërinë midis sistemeve të ndryshme (siç janë: sistemet për emërtimet lëndore, bazat e të dhënave gjeografike, klasifikimet sipas zhanrit/formës etj.).

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
822		Të dhënat e barasvlershme në sistemet e tjera	r
	a	<i>E dhëna në sistemin tjetër</i>	nr
	d	<i>Data e qasjes</i>	nr
	2	<i>Kodi i sistemit</i>	nr
	3	<i>Numri i regjistrimit</i>	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Nuk është i përcaktuar</i>
2		<i>Lloji i marrëdhënies</i>
	2	<i>Përputhje e përpiktë</i>

Treguesi përcakton llojin e marrëdhënies midis pikëqasjes dhe të dhënave të barasvlershme në sistemet e tjera.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha 2 dhe 3 janë përshkruar në kapitullin *Nënfusha e kontrollit*.

822a E dhëna në sistemin tjetër

E dhëna në sistemin tjetër (p.sh. në sistemin e emërtimeve lëndore, në bazat e të dhënave gjeografike etj.), që i përshtatet pikëqasjes.

822d Data e qasjes

Data, kur e dhëna e barasvlershme është gjetur në sistemin tjetër.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për cilindo lloj të pikëqasjes.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 2XX** *BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA*
4XX *BLLOKU I VARIANTEVE TË PIKËQASJEVE*
5XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE NË LIDHSHMËRI*
7XX *BLLOKU I PIKËQASJEVE TË NJËSUARA NË GJUHËT DHE/APO SHKRIMET E TJERA*

SHEMBUJ

1. *

152	□□	bsgc
200	□1	9slv aEdison bThomas Alva f1847-1931
822	□2	2CONOR 3103012451 aEdison, Thomas Alva, 1847–1931 d20240724 <i>(Regjistrimi nga SGC. Në nënfushën 8223 është shënuar numri i regjistrimit të njësuar për shpikësin Edison në bazën e të dhënave CONOR, ndërsa në nënfushën d data e gjetjes së të dhënës.)</i>